



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:267983

Datë: 12.11.2020

Numri i dokumentit: 01267185

A.nr.616/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit M.me seli në Gj. kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 11.11.2020, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET Kërkesëpadia e paditësit M. me seli në Gj.

ANULOHET Aktvendimi nr.01.3.2.2/82 datës 15.02.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit R-459/12.01.2018 të lëshuar nga ZBD Ferizaj, si të pa bazuar.

Paditësi M. me seli në Gj., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 03.04.2018, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të aprovet padia në tërësi si e bazuar, të anulohet aktvendimi i të paditurës nr. 01.3.2.2/82 datës 15.02.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, si dhe të obligohet Dogana e Kosovës që mjetet monetare në shumë të paguara në emër të detyrimeve doganore t'i kthehen paditësit.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën publike, paditësi deklaroi: se e kundërshton vendimin e të paditurës Doganës së Kosovës për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe për shkak të rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit. Paditësi me tej ka deklaruar se duke konsideruar se e paditura ka bërë shkeljet ligjore të referuara në padi, përkatësisht nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave lidhur me nenin 123 të U.A. nr.11/2009, pasi që paditësi me rastin e paraqitjes së mallit, për zhdoganim me anë të DUD-it kontestues, e po ashtu edhe në procedurën e ankesës, i ka bashkangjitur lëndës dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit, sikurse janë, fatura, urdhërpagesat bankare në emër të saj si dhe kontratën për shitblerjes së mallrave, të gjitha të harmonizuara në kuptim të vlerës. E paditura konsiderojmë se ka konstatuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike, pasi që me rastin e rivlerësimit, është mbështetur në të dhënët e disponueshme, por me këtë rast, nuk ka bërë një krahasim objektiv të

llojit të mallit, cilësisë së tij, sasisë së kontraktuar dhe parametrave tjerë tregtar që mund të ndikojnë në çmimin e mallit. Sa i përket arsytimit se nuk kanë mundur të pranohen dokumentet e transaksionit, sepse në faturën lëndore nuk janë theksuar detajet e transaksionit, konsiderojmë se janë të pa qëndrueshme, pasi që siç shihet nga shkresat e lëndës, fatura i ka të gjitha elementet e nevojshme, pastaj urdhër-pagesat bankare kanë të evidentuar numrin e faturës e cila është paguar me anë të tyre, në këto transfere bankare po ashtu evidentohet edhe eksportuesi si përfitues i pagesës. Po ashtu konsiderojmë se është i pa qëndrueshëm edhe arsytimi lidhur me mungesën e deklaratës eksportuese pasi që mungesa e këtij dokumenti nuk i humbë vlerën prodhuese dokumenteve të tjera të transaksionit të cilat janë të harmonizuara në mes vete. Si pasoj e rivlerësimit paditësi ka paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore shumë prej 2,040.76 Euro. Duke pasur parasysh te theksuarat, edhe provat e administruara kërkojmë nga gjykata që ta vendos këtë lëndë në mënyrë meritore, ashtu që të bëjë aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërësi si të bazuar duke anuluar aktvendimin e atakuar, dhe të detyroj të paditurën që ti kthej paditësit shumë prej 2,040.76 Euro të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit me kamatë ligjore në shkallë prej 8%, nga dita e pagesës e deri në kthimin e plotë.

E paditura në përgjigje në padi datës 31.10.2019 dhe përmes të autorizuarit në seancën publike deklaroi: se e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe i propozoi gjykatës që të njëjtën ta refuzoi në tërësi si të pa bazuar, dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë, për arsye se vendimi i atakuar është marrë, konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, dhe nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se vendimi është marrë me shkelje ligjore, për arsye se siq u cek më lartë, paditësi nuk ka arritur që me dokumentacion të mjaftueshëm të vërtetoi pretendimet e tij se vlera e paguar për mallin kontestues është reale, për më tepër në faturën e mallit nuk janë cekur detajet e bankës së përfituesit, pastaj mungon deklarata ekspertuese nga shteti dërgues, me të cilën do të vërtetonte se çmimi dalës nga shteti dërgues është po i njëjti i cili është deklaruar edhe në import. Referuar të theksuarave si më lartë e paditura ka bërë rivlerësimin e mallit konform nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, përkatësisht metodën e 6-të të vlerësimit, për arsye që u cekën më lartë ashtu siq janë të theksuara në vendimin kontestues. Andaj mbi bazën e theksuarave i propozojmë gjykatës që ti refuzoj pretendimet e paditësit, dhe të lë në fuqi vendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 11.11.2020, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt. 31.10.2019 nga Dogana e Kosovës, Aktvendimi nr.01.3.2.2/82 i dt.15.02.2018, nga Dogana e Kosovës, Deklaratat Doganore, Urdhërpagesat Bankare, Fatura e mallit, Ankesa e paditësit me nr.prot.82/08.02.2018, Aktgjykimi A.nr.1856/17, i dt.14.12.2017, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kontrata e shitjes, Packing List.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 11.11.2020, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në ankes-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar andaj vendosi që lëndën ta kthej në rishqyrtim për këto arsye:

Me rastin e ekzaminimit të vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës ka konfirmuar rivlerësimin e Sektorit të pranimit qendror, për mallin lëndor të zhdoganuar me Deklaratën Unike Doganore kontestuese, duke konstatuar se ky sektor ka aplikuar drejt metodën e 6 të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ku si provë janë marrë të dhënat e disponueshme-dosja e vlerës nga Dogana e Kosovës. E paditura gjithashtu dokumentacionin përcjellës të mallit e ka konsideruar si provë të pamjaftueshme duke arsyetuar se në faturën përcjellëse të mallit nuk janë të cekura detajet e bankës së përfituesit, mungon deklarata e eksportit,

andaj nuk mund të vepohet sipas kërkesës së paditësit që mallit të vlerësohet sipas dokumentacionit të paraqitur nga paditësi.

Edhe pse e paditura ka nxjerr vendimin kontestues në bazë të kërkesës së paditësit të ushtruar ndaj vendimit R-459/12.01.2018 të lëshuar nga ZBD në Ferizaj, gjykata konsideron se nuk është i mjaftueshëm vetëm konstatimi se Sektori i pranimit qendror ka aplikuar drejt metodën e vlerësimit kur ka kontestuar vlerën e mallit sipas të dhënave të disponueshme, pa u shqyrtuar asnjë pretendim i paditësit i cili kërkon që të shqyrtohet validiteti i dokumentacionit përcjellës të mallit. Asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas metodës së 6 të vlerësimit, në rast se vlera e dokumentacionit përcjellës të mallit nuk përputhet me të dhënat e disponueshme, pa u bërë verifikimi i vlerës së deklaruar të mallit lëndor gjegjësisht pa u shqyrtuar metodat paraprake të vlerësimit nga neni 33-34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Paditësi i ka paraqit gjykatës faturën e mallit lëndor, dy transferet ndërkombëtare të datës 04.10.2017 dhe 09.01.2018 Pro Credit Bank, të cilat përmbajnë numrin e njëjtë të faturës përcjellëse të mallit, pastaj kontratën e shitjes, fakte këto të cilat e paditura fare nuk i ka shqyrtuar apo kontestuar në procedurën administrative të ankesave.

Për gjykatën është e papranueshme që mos të shqyrtohet validiteti i dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, vetëm për faktin siç theksohet në arsyetimin e vendimit kontestues, se në faturë mungojnë detajet e bankës së përfituesit dhe se mungon deklarata e eksportit. E paditura nuk i ka bazuar konstatimet e veta në asnjë dispozitë ligjore, kur e konsideron dokumentacionin e mallit si të pamjaftueshëm, nuk është dhënë asnjë sqarim ligjor se deklarata eksportuese a është dokument i obligueshëm për tu pranuar vlera e deklaruar e mallit lëndor sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109.

Gjykata kërkon nga e paditura Dogana e Kosovës që në ri procedurë para se të aplikoj të dhënat e disponueshme që disponon për mallin lëndor, të vlerësoj metodat paraprake të vlerësimit, të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit përcjellës të mallit në aspektin e harmonizimit të vlerës së mallit të deklaruar, ashtu që të shqyrtoj pretendimet e paditësit se ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 mbi implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, të verifikohet vlera e paguar e faturës së mallit lëndor sipas dy transfereve bankare dhe kontratës së shitjes, duke konstatuar se a harmonizohet dokumentacioni në kuptim të vlerës. Në ri procedurë e paditura të sqaroj se cila bazë ligjore kërkon që dokumentacionit përcjellës të mallit duhet bashkangjitur deklaratën eksportuese. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallit.

Duke pasur parasysh konstatimet e sipërcekura, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar të mos dihen arsyet e mos kontestimit të vërtetësisë së dokumentacionit të mallit të prezantuar në procedurën administrative të ankesave.

Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në autorizimet nga nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejt të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejt të çështjes.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative/Divizioni Fiskal
A.nr.616/18 datë 11.11.2020

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.